

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                  |
|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | "U prita me një tortë rozë dhe dy flamingo", Rama flet nga SHBA-ja: Një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Britania për mua |
| ADRESA  | https://newsbomb.al/aktualitet/u-prita-me-nje-torte-roze-dhe-dy-flamingo-rama-flet-nga-s-hba-ja-nje-n-i402106                    |
| BURIMI  | newsbomb.al                                                                                                                      |
| GJENDJA | online                                                                                                                           |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 19:03:37 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 18:59:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 51f650bc5056c69f68233f1d3e232cc4a790c477cd033130a2112194fec862ef |
| TEKSTI     | a10e8c3dbac820fa3e8dfafa617abeb3156587aeaffcea280a47c1a9e8d8e6bc |
| PAMJA      | 3a96acc6b595495d71d429fc82953b7acf8a2a206148ca31c65b53f1a413c0b2 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 926c6e2b8854e5741ede543bc618361f79ded419046610a6e2234d4fec2e6b6f                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/926c6e2b8854e5741ede543bc618361f79ded419046610a6e2234d4fec2e6b6f

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



12 numrat e parë FALAS!  
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë &amp; Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



## Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

26 Shtator 2026, 20:59

# “U prita me një tortë rozë dhe dy flamingo”, Rama flet nga SHBA-ja: Një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Britania për mua



Shkruar nga Newsbomb



Edi Rama

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, Neë Jork, gjatë vizitës së tij në SHBA, ku ka marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Gjatë fjalës së tij, Rama u ndal te marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe diasporës, duke theksuar rolin e emigrantëve në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Gjithashtu, ai kujtoi darkën e zhvilluar në 2015 në Staten Irelant, ku ishte së bashku me Hashim Thaçin dhe kishin diskutuar për samitin e parë të Diasporës në Tiranë.

*“Këtu në Staten Island në 2015-ën unë isha në një darkë së bashku me Hashim Thaçin dhe këtu diskutuam për samitin e parë të Diasporës në Tiranë dhe ishim bashkë me Thaçin. Një dekadë pas samitit kanë ndodhur shumë gjëra,”* thekson Rama.

Po ashtu, ai foli për krijimin e një regjistri kombëtar të diasporës të cilin e përshkroi si një dritare për shqiptarët jashtë vendit që dëshirojnë të investojnë në Shqipëri.

Gjithashtu Rama u ndal edhe te hedhja e vezëve, ku u shpreh me humor se një nga personat që hodhi vezë kishte ardhur nga Britania dhe shpesh ai e “të ketë kaluar mirë

Revista



Abonohu tani dhe lexoje &gt;

## Lajmet e fundit



Rajoni

Erdogan i kundërpërgjigjet Netanyahu pas akuzë për “diktator”. Vendi i kriminelëve të luftës është në gjykatë



Sporti

Tifozët bëjnë “detyrën” për Kombëtaren, zbulohet numri “bombastik” i bileteve të shitura

Zbulohet më shumë artikuj &gt;

me policinë e Neë Yorkut”.

“Vezët që më hodhën mua para pak netësh, duke treguar se ajo çka ndodh në Shqipëri i ka integruar shqiptarët. Një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Britania për të hedhur vezë. Shpresoj të ketë kaluar mirë me policinë e New Yorkut,” shprehet Rama.

#### Fjala e Ramës:

Faleminderit për mikpritjen. Të them të drejtën kur na thanë mbrëmë se një stuhì e madhe po vinte mendum se do të ishte pengesë që të mbledheshit këtu, ju jo vetëm u mbledhët, por ndaluat edhe stuhinë nga ajo që parashikohej. Më vjen mirë që jam këtu, ku thonë se është i vetmi vend në botë, ku mund të gjedh Ismail Qemalin, Isa Boletinin dhe Rusveltin pranë njëri-tjetrit.

Jemi në Amerikë, por ky është një territor i pushtuar jozyrtarisht nga shqiptarët. Jemi këtu për të ndarë disa gjëra që kanë ndodhur në të shkuarën. Këtu në Staten Irelant në 2015-ën unë isha në një darkë së bashku me Hashim Thaçin dhe këtu diskutuam për samitin e parë të Diasporës në Tiranë dhe ishim bashkë me Thaçin. Një dekadë pas samitit kanë ndodhur shumë gjëra.

Çdo gjë lidhej me dërgesat që shqiptarët dërgonin për të mbajtur familjen, por tashmë shumëçka ndodh dhe janë ndërtuar ura me interesa, interesa, investime dhe rikthime shqiptarësh në tokën amë. Në këto vite ka një fakt të jashtëzakonshëm që e vendos çdo emigrant në një pedestal të posaçëm. Çdo familje shqiptarë ka përfituar nga dërgesat financiare të diasporës, ku 9 nga 10 shqiptarë, kanë ndërtuar çati mbi kokë, janë shkollar apo kanë përmirësuar jetën falë çdo të afërmi në diasporë.

Ky është një nder i madh që e mbulon me lavdi diasporën. Por siç e thashë nuk jemi më në fazën që diaspora jepte dhe Shqipëria vetëm merrte, por jemi në një lidhje dhe partneritet të fortë, që ka hyrë në rrugën e një zhvillimi dhe ku sot kemi organe të një trupi të ri që kemi ndërtuar. Institucionet e diasprës, këshillet, agjencitë dhe samitet që ndihmojnë për angazhime të ndryshme.

Po krijojmë një regjistër kombëtar të diasporës si një dritare për ata që duan të investojnë sadopak në Shqipëri. Organicitet ishin edhe vezët që më hodhën mua para pak netësh, duke treguar se ajo çka ndodh në Shqipëri i ka integruar shqiptarët. Një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Britania për të hedhur vezë. Shpresoj të ketë kaluar mirë me policinë e Neë Yorkut.

Pastaj në trupën e angazhuar kryesor ishte një shqiptar që punonte këtu. Falë kësaj ndërlidhjeje mes Shqipërisë dhe diasporës, u ndodha fiks si në Shqipëri, me protesta dhe me plot shqiptarë. U prita me një tortë rozë me dy flamingo sipër dhe u ndjeva shumë mirë.

Nuk vuajmë më faktin që kafshët e natyra vritet dhe nuk merret më njeri me të, por kafshët dhe natyra mbrohen dhe njerëzit shqetësohen. Ka ardhur koha kur Shqipëria thotë se ka edhe më mirë dhe është e vërtetë që ne së bashku mund të bëjmë çdo ditë e më mirë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Kur pa që mu hodhën ca vezë erdhi me vrap kryepolici i Shqipërisë, Pjerin Ndreu. Një nga kryetarët më të mirë të bashkive, që vuan edhe nga fakti që Lezha nuk bëhet kryeqytet, më la porosi të them diçka për lezhjanët sepse ka të tillë në sallë. Jeni me fat që e keni.

#### Sondazh

Poll

#### Lexo gjithashtu





E Shtunë 20:34

## Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, shkodrani Elvis Shkambi shpallet FAJTOR



Aktualitet

Si në filmat aksion: Të rinjtë me "Audi" Q7 nuk iu binden Policisë për të ndaluar, përplasen me makinën e patrullës

E Shtunë 18:49



Aktualitet

I jep fund jetës i dënuari në burgun e Reçit, pasi vrau gruan familjarët "e braktisën", asnjë takim që nga 2025 (EMRI-DETAJE)

E Shtunë 17:56



E Shtunë 17:49 Newsbomb

## Plagosja e 10-vjeçares shqiptare në Athinë, DETAJE: Urdhrin për atentat ndaj lokalit të Denis Lulit e dha "Mafia e Burgjeve"



Aktualitet

Panik në autostradën Tiranë-Elbasan, autobusi i pasagjerëve përfshihet nga flakët

E Shtunë 17:26



Aktualitet

RRËQETHËSE: Çifti shqiptar që vdiqën në Athinë ishin në pritje të fëmijës së tyre të parë, Florida Hoxha një avokate e zonja, FLET miksha



E Shtunë 15:57

## Aksident i frikshëm pranë Sukthit, "Volkswagen"-i përmbysset në mes të autostradës



Aktualitet

Nga Tirana në Korçë, 43 restorantet dhe hotelet që u furnizuan me djathë të helmuar, kompania "INITALY RISTO&GUSTO" ia hodhi me një gjobë (INVESTIGIMI)

E Shtunë 15:20



Aktualitet

ISP zbulon sukseset dhe kritikën ndaj ambasadorit amerikan të Shqipërisë që janë emëruar gjatë 35 viteve (LISTA)

E Shtunë 15:21 Newsbomb



E Shtunë 15:02 Newsbomb

## Po rregullonte pompën e varkës dhe ra në kontakt me rrymën elektrike, 28-vjeçari VDES në duart e mjekëve të Durrësit





#### Aktualitet

Shijaku vlerëson kontributin e agronomit që i shërbeu brezave të tërë, emri i ENVER DUKES skalitet në një prej rrugëve të qytetit

🕒 E Shtunë 14:54



#### Aktualitet

29-vjeçari me "Toyota" merr përpara këmbësoren në vijat e bardha, niset me urgjencë në spital (EMRI)

🕒 E Shtunë 14:50 Newsbomb



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.